



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Nr.09/84

Datë: 02.09.2022

THIRRJE PUBLIKE

Për Mbështetje Financiare Publike të Organizatave Jo-Qeveritare në Zbatimin e Aktiviteteve Kulturore dhe Rinore në Komunën e Shtimes

Në bazë të nenit 12 të Rregullorës MF Nr.04.2017 mbi kriteret, standardet, dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve:

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) e Komunës së Shtimes shpallë thirrje për të gjitha organizatat jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës dhe individët, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës dhe rinisë, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zbatimin e aktiviteteve, zhvillimin, masovizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjëve në Komunën e Shtimes .
2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte/programet e tyre për fushat prioritare në vijim:
2.1. Të gjitha OJQ-të, Kulturore dhe Rinore dhe individët në Komunën e Shtimes, programi i të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës dhe rinisë,
3. Organizatat jo-qeveritare dhe individët mund të aplikojnë me një projekt që kontribuon në avancimin dhe fuqizimin e sektorit të kulturës dhe rinisë.
4. Vlera totale e planifikuar, e thirrjes është: **10.000 euro**
5. Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë , nga data **02.09.2022** deri më datë **16.09.2022**
6. OJQ-të dhe individët mund të aplikojnë me projekte në kuadër të kësaj thirrjeje, por vetëm me një projekt për fushën sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të thirrjes është deri në **dhjetor të vitit 2022**. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes publike.
Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat venrojnë në Komunën e Shtimes, së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike.
OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e kulturës dhe rinisë.
OJQ-të duhet po ashtu të kenë të kryera transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofertuesit të mbështjetjes

financiare dhe të gjithë ofertuesve tjerë të mbështetjës financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës OJQ duhet të paraqes prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë , të cilët së bashku me udhëzimet për aplikantë janë në dispozicion në uebfaqën e internetit të Komunes së Shtimes.
Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën:
Rruga "Tahir Sinani" Nr.50, 72000 Shtime, Republika e Kosovës / Zyra e DKRS .

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlersimit të aplikacioneve, kontraktimit, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në zyrat e DKRS.



Drejtoresha, Albana Fazliu